BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# DRAFT PASQYRAT FINANCIARE TË BQK-së
/për/deri tremujorin e tretë 2019/
***-Raport i ndërmjetëm i paaudituar-***

**Departamenti për Planifikim dhe Raportim Financiar**

Pasqyrat financiar të BQK-së për tremujorin e tretë 2019

E përcaktuar me Ligjin 03/L-209 "Mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (me iniciale BQK), si kornizë raportuese për përgatitjen e pasqyrave financiare janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, përkatësisht nenit 58 të Ligjit të përmendur më lartë. Këto pasqyra për tremujorin e tretë përfshijnë *pasqyrën e gjendjes financiare* dhe *llogarinë e përmbledhur të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe rezerva (ekuitet).*
Viti financiar i BQK-së përputhet me vitin kalendarik, si rrjedhojë, data e raportit për pasqyrat financiare të tremujorit të tretë 2019 është 30 shtator 2019.

**Shkurtesa të përdorura në raport**:

BQK – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

DST (SDR) – Të Drejtat Speciale të Tërheqjes

SNP – Sistemi ndërbankar i pagesave

BQE (ECB) – Banka Qendrore Evropiane

USD – Dollar Amerikan

# Pasqyra e gjendjes financiare

sipas të dhënave me:

| | Shënim | 30 shtator 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|
| **Mjetet** | | | |
| Paraja e gatshme | 5 | 332,029,782.03 | 285,376,364.49 |
| Llogaritë rrjedhëse | 6 | 263,230,505.31 | 34,797,033.53 |
| Letrat me vlerë | 7 | 593,909,297.82 | 758,889,559.97 |
| Plasmanët në tregun e parasë | 8 | 249,367,251.34 | 183,734,361.96 |
| Mjetet e ndërlidhura me FMN | 9 | 311,727,100.86 | 326,051,143.81 |
| Prona dhe pajisjet | 10 | 4,853,339.86 | 5,015,903.52 |
| Mjetet e paprekshme | 11 | 1,770,367.06 | 1,790,110.48 |
| Mjete tjera | 12 | 1,484,246.19 | 1,410,439.92 |
| **Gjithsej mjetet** | | **1,758,371,890.47** | **1,597,064,917.68** |
| **Detyrimet** | | | |
| Ndaj bankave komerciale në vend | 13 | 425,935,262.74 | 343,393,712.93 |
| Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN | 14 | 309,914,659.70 | 321,854,091.99 |
| Ndaj institucioneve qeveritare | 15 | 913,094,488.59 | 762,900,887.21 |
| Ndaj institucioneve publike dhe komerciale | 16 | 49,567,303.10 | 110,862,984.73 |
| Nga huamarrja/et | 17 | 2,266,259.07 | 2,266,259.07 |
| Detyrime tjera vendore | 18 | 1,436,164.60 | 1,797,522.58 |
| Gjithsej detyrimet | | **1,702,214,137.80** | **1,543,075,458.51** |
| **Kapitali dhe rezervat** | | | |
| Kapitali i autorizuar | 19 | 30,000,000.00 | 30,000,000.00 |
| Fondi rezervë | 20 | 23,989,459.17 | 21,801,120.78 |
| Neto rezultati i periudhës | | 2,168,293.50 | 2,188,338.39 |
| **Gjithsej kapitali dhe rezervat** | | **56,157,752.67** | **53,989,459.17** |
| **Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat** | | **1,758,371,890.47** | **1,597,064,917.68** |

Shënimet prej faqes 6 deri 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të shpalosura më poshtë janë aprovuar nga menaxhmenti më datë 29 nëntor 2019 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:

Fehmi Mehmeti
*Guvernator*

Faton Ahmetaj
*Drejtor për Planifikim dhe Raportim Financiar*

# Pasqyra e përmbledhur e të ardhurave

| | Shënim | 30 shtator 2019 | 30 shtator 2018 |
|---|---|---|---|
| **Të hyrat nga interesi (kamata)** | | | |
| Të hyrat nga interesi | | 2,539,436.43 | 1,996,568.24 |
| Shpenzimet nga interesi | | (1,075,799.53) | (711,236.92) |
| **Neto të hyrat nga interesi** | 21 | **1,463,636.90** | **1,285,331.32** |
| **Të hyrat nga tarifat dhe ndalesat** | | | |
| Të hyrat nga tarifat dhe ndalesat | | 2,032,056.35 | 1,626,503.84 |
| Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat | | (367,724.39) | (226,686.05) |
| **Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat** | 22 | **1,664,331.96** | **1,399,817.79** |
| **Të hyrat nga aktiviteti rregullator dhe të hyra tjera operative** | | | |
| Të hyrat nga aktiviteti rregullator | 23 | 3,357,184.16 | 3,162,559.06 |
| Të hyrat nga grantet | 24 | 86,356.87 | 73,587.11 |
| Të hyrat tjera operative | 25 | 2,927.55 | 7,473.66 |
| **Të ardhurat operative** (21+22+23+24+25) | | **6,574,437.44** | **5,928,768.94** |
| **Shpenzimet administrative** | | | |
| Shpenzimet për personelin | 26 | (3,286,820.91) | (3,020,530.54) |
| Zhvlerësimi dhe amortizimi | 10,11 | (771,498.58) | (770,729.12) |
| Shpenzime të përgjithshme administrative | 27 | (911,237.20) | (785,559.08) |
| **Shpenzimet administrative**[1] | | **(4,969,556.69)** | **(4,576,818.74)** |
| **Neto rezultati pa efektin e kursit të këmbimit** | | **1,604,880.75** | **1,351,950.20** |
| Neto fitimi/(humbja) nga kursi i këmbimit valutor | 28 | 563,412.75 | 392,713.79 |
| **Neto rezultati i periudhës** | | **2,168,293.50** | **1,744,663.99** |

Shënimet prej faqes 6 deri 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

[1] Gjithsej shpenzimet operative = shpenzimet administrative + shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat.

## Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet (kapital dhe rezerva)

| | Kapitali i autorizuar | Fond i rezervave | Neto rezultati i periudhës | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|
| ***Saldo me 01 janar 2018*** | **30,000,000.00** | **22,682,588.69** | **(881,467.91)** | **51,801,120.78** |
| *Rezultati financiar i periudhës* | - | - | 2,188,338.39 | 2,188,338.39 |
| *Transferi në fondin rezervë* | - | (881,467.91) | 881,467.91 | - |
| *Transferi në kapital të autorizuar* | - | - | - | - |
| ***Saldo më 31 dhjetor 2018*** | **30,000,000.00** | **21,801,120.78** | **2,188,338.39** | **53,989,459.17** |
| | | | | |
| ***Saldo më 01 janar 2019*** | **30,000,000.00** | **21,801,120.78** | **2,188,338.39** | **53,989,459.17** |
| *Rezultati financiar i periudhës* | - | - | 2,168,293.50 | 2,168,293.50 |
| *Transferi në fondin rezervë* | - | 2,188,338.39 | (2,188,338.39) | - |
| *Transferi në kapital të autorizuar* | - | - | - | - |
| ***Saldo më 30 shtator 2019*** | **30,000,000.00** | **23,989,459.17** | **2,168,293.50** | **56,157,752.67** |

Shënimet prej faqes 6 deri 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# Pasqyrat financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

## 1. Institucioni Raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - BQK, e cila operon sipas Ligjit nr. 03/L-209"Mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" të aprovuar në korrik të vitit 2010.

## 2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

### Korniza Raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të kostos historike dhe të harmonizuara sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Valuta e funksionale dhe e prezantuar

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në EURO, që është valutë zyrtare funksionale e Kosovës. Në rast se vlerat janë të shprehura në valuta tjera atëherë do të këtë shënim përkatës aty ku janë të paraqitura ato.

## 3. Politikat kontabël

Pasqyrat financiare janë të përgatitura duke shfrytëzuar konsistencën e politikave kontabël, dhe duhet theksuar se nuk ka pasur ndonjë politikë të re ose ndryshim në politikat e aplikuara kontabël.

## 4. Menaxhimi i rrezikut financiar

Rreziku financiar në BQK është i paraqitur në formën e: rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional, rrezikut kreditor dhe rrezikut të tregut. Rreziku financiar në BQK ndërlidhet kryesisht me punët e menaxhimit të mjeteve dhe menaxhohet nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve në përputhje me politikën e menaxhimit të mjeteve të aprovuar nga Bordi i BQK-së. Mjetet e ekspozuara nga aktiviteti i menaxhimit financiar të tyre janë kryesisht në shtete të Bashkimit Evropian me vlerësim kreditor të investueshëm (prej AAA deri BBB+/ Aaa deri A3).

## Menaxhimi i Rrezikut të Likuiditetit (vazhdim)

### Vlerat bartëse sipas maturitetit të mbetur

| | Shënim | Shuma e bartur | më pak se 3 muaj | 3-6 muaj | 6 muaj - 1 vit | 1 - 5 vite | mbi 5 vite |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **30 shtator 2019** | | | | | | | |
| **Mjetet** | | | | | | | |
| Paratë e gatshme | 5 | 332,029,782.03 | 332,029,782.03 | - | - | - | - |
| Llogaritë rrjedhëse | 6 | 263,230,505.31 | 263,230,505.31 | - | - | - | - |
| Letra me vlerë | 7 | 593,909,297.82 | 17,709,998.43 | 250,153.96 | 23,864,246.43 | 548,866,748.71 | 3,218,150.29 |
| Plasmanët në tregun e parasë | 8 | 249,367,251.34 | 9,367,251.34 | - | 240,000,000.00 | | - |
| Mjetet e ndërlidhura me FMN | 9 | 311,727,100.86 | 177,387,156.86 | 8,795,323.00 | 42,380,308.00 | 83,164,313.00 | - |
| | | **1,750,263,937.36** | **799,724,693.97** | **9,045,476.96** | **306,244,554.43** | **632,031,061.71** | **3,218,150.29** |
| **Detyrimet** | | | | | | | |
| Ndaj bankave vendore | 13 | (425,935,262.74) | (425,935,262.74) | - | - | - | - |
| Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN | 14 | (309,914,659.70) | (175,574,715.70) | (8,795,323.00) | (42,380,308.00) | (83,164,313.00) | - |
| Ndaj institucioneve qeveritare | 15 | (913,094,488.59) | (913,094,488.59) | - | - | - | - |
| Ndaj institucioneve publike dhe komerciale | 16 | (49,567,303.10) | (49,567,303.10) | - | - | - | - |
| Nga huamarrja / et | 17 | (2,266,259.07) | - | - | - | (793,190.67) | (1,473,068.40) |
| Detyrime tjera vendore | 18 | (1,436,164.60) | (1,436,164.60) | - | - | - | - |
| | | **(1,702,214,137.80)** | **(1,565,607,934.73)** | **(8,795,323.00)** | **(42,380,308.00)** | **(83,957,503.67)** | **(1,473,068.40)** |
| | | **48,049,799.56** | **(765,883,240.76)** | **250,153.96** | **263,864,246.43** | **548,073,558.04** | **1,745,081.89** |
| **31 dhjetor 2018** | | | | | | | |
| **Mjetet** | | | | | | | |
| Paratë e gatshme | 5 | 285,376,364.49 | 285,376,364.49 | - | - | - | - |
| Llogaritë rrjedhëse | 6 | 34,797,033.53 | 34,797,033.53 | - | - | - | - |
| Letra me vlerë | 7 | 758,889,559.97 | (0.00) | - | 227,220,601.98 | 531,668,957.99 | - |
| Plasmanët në tregun e parasë | 8 | 183,734,361.96 | 163,734,361.96 | - | 20,000,000.00 | - | - |
| Mjetet e ndërlidhura me FMN | 9 | 326,051,143.81 | 170,173,004.81 | 8,530,040.00 | 17,060,081.00 | 130,288,018.00 | - |
| | | **1,588,848,463.76** | **654,080,764.79** | **8,530,040.00** | **264,280,682.98** | **661,956,975.99** | **-** |
| **Detyrimet** | | | | | | | |
| Ndaj bankave vendore | 13 | (343,393,712.93) | (343,393,712.93) | - | - | | |
| Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN | 14 | (321,854,091.99) | (165,975,952.99) | (8,530,040.00) | (17,060,081.00) | (130,288,018.00) | - |
| Ndaj institucioneve qeveritare | 15 | (762,900,887.21) | (762,900,887.21) | - | - | - | - |
| Ndaj institucioneve publike dhe komerciale | 16 | (110,862,984.73) | (110,862,984.73) | - | - | - | - |
| Nga huamarrja / et | 17 | (2,266,259.07) | - | - | - | (679,877.72) | (1,586,381.35) |
| Detyrime tjera vendore | 18 | (1,797,522.58) | (1,797,522.58) | - | - | - | |
| | | **(1,543,075,458.51)** | **(1,384,931,060.44)** | **(8,530,040.00)** | **(17,060,081.00)** | **(130,967,895.72)** | **(1,586,381.35)** |
| | | **45,773,005.25** | **(730,850,295.65)** | **-** | **247,220,601.98** | **530,989,080.27** | **(1,586,381.35)** |

## 5. Paraja e gatshme

| | 30 shtator 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| Paraja e gatshme | 332,029,782.03 | 285,376,364.49 |
| **Gjithsej** | **332,029,782.03** | **285,376,364.49** |

Vërehet një rritje e saldos me 30 shtator 2019 krahasuar më 31 dhjetor 2018. Kjo rrjedh nga mundësitë e vogla të plasimit (afatizimit) të mjeteve në tregjet financiare si rrjedhojë e normave shumë të ulëta dhe negative (për valutën euro). Si rrjedhojë është vendosur që të mbahen më shumë mjete si para të gatshme për t'ju ikur normave negative, që bankat korrespondente na ngarkojnë mbi limite të caktuara në llogaritë rrjedhëse (nostro).

## 6. Llogaritë rrjedhëse (nostro - me bankat jorezidente)

Përbërja e llogarive rrjedhëse me banka jovendore është si më poshtë:

| | 30 shtator 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| Deutsche Bundesbank | 39,999,999.00 | 500,000.00 |
| Raiffeisen Zentralbank | 9,900,003.64 | 9,919,971.54 |
| Banque centrale du Luxembourg | 343.36 | 343.36 |
| Deutsche Bank | 211,628,546.45 | 24,133,499.52 |
| Nostro Acc. Commerzbank AG | 494,650.00 | 9,844.00 |
| Nostro Acc. Bayerische Landesbank | 989,992.72 | 9,998.02 |
| Nostro acc. with FED | 216,970.14 | 223,377.09 |
| **Gjithsej** | **263,230,505.31** | **34,797,033.53** |

Pozicioni i *llogarive rrjedhëse* (nostro) krahasuar më 31 dhjetor 2018 është rritur dukshëm, ndryshimi është rrjedhë e aktivitetit të këtyre llogarive dhe e menaxhimit të portofolios së mjeteve e efektuar edhe nga normat negative në tregjet financiare (përkatësisht shënimeve 5, 6, 7 dhe 8, që janë shumë ngushtë të lidhura njëra me tjetrën referuar nga aspekti i menaxhimit të mjeteve). Rritja në këtë grup mund të ketë efekt në rritjen e shpenzimeve të interesit[2] nga normat negative qe bankat korrespondente (përjashtuar këtu llogarinë me FED – Federal Reserve) aplikojnë në llogaritë e shpalosura më lartë.

## 7. Letrat me Vlerë (Bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare)

Të dy kategoritë që bëjnë pjesë në kuadër të grupit nën shënimin 7 janë letra të borxhit të lëshuara (emetuara) nga vende dhe institucione të ndryshme të Evropës, në analitikë shpërndarja gjeografike është sipas listimit në faqe 9 (në tabelën *sipas shpërndarjes gjeografike*). Bonot e Thesarit të shpalosura po ashtu në faqe 9, kanë maturitet të kontraktuar deri në një vit. Ndërsa ato të obligacioneve qeveritare kane maturitet të kontraktuar deri në pesë vite. Të gjitha janë në Euro dhe kanë norma të interesit efektiv qe lëvizin nga 0.019%

[2] Për periudhën janar – shtator kemi paguar diku rreth 517 mijë euro interesa nga saldot e rrjedhëse të llogarive me bankat korrespondente apo mesatarisht rreth 57 mijë euro ne muaj (e gjitha e paraparë në kuadër të buxhetit 2019).

deri 3.021% vjetore në vitin 2019 (në vitin 2018 periudha e njëjtë raportuese: 0.019% deri në 3.021% vjetore).

**Letrat me vlerë sipas shpërndarjes gjeografike dhe llojit:**

**Letra me vlerë (sipas shpërndarjes gjeografike):**

| | 30 shtator 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| Gjermani | 66,637,454.18 | 67,125,782.03 |
| Francë | 10,021,779.48 | 10,029,732.20 |
| Holandë | 12,560,747.62 | 12,772,324.34 |
| Itali | - | 176,834,343.28 |
| Slloveni | 21,426,333.02 | 22,137,623.18 |
| Luksemburg | 89,283,400.78 | 90,243,505.98 |
| EuroFima-Switzerland (Zvicër) | 6,042,269.50 | 6,039,989.48 |
| KommuneKredit (Danimarkë) | 6,051,399.91 | - |
| Austria | 79,475,419.67 | 79,463,267.63 |
| Irlandë | 104,305,794.39 | 105,389,752.07 |
| Kosovë | 198,104,699.26 | 188,853,239.79 |
| **Gjithsej** | **593,909,297.82** | **758,889,559.97** |

**Letra me vlerë (sipas llojit):**

| | 30 shtator 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| Bonot e thesarit | 1,148,799.05 | 5,998,422.16 |
| Obligacione | 592,760,498.77 | 752,891,137.81 |
| **Gjithsej** | **593,909,297.82** | **758,889,559.97** |

Në kuadër të grupit vërehet një zvogëlim i pozicionit krahasuar me periudhën 31 dhjetor 2018 që është rrjedhë normale e menaxhimit të portfolios, kryesisht e bazuar në sigurinë e mjeteve së pari pastaj edhe në mundësitë për norma më optimale të kthimit të mjeteve.

## 8. Plasmanët në tregun e parasë (me bankat jorezidente)

Në kuadër të këtij grupimi bëjnë pjesë plasmanët në tregun e parasë në bankat tona korrespondente. Norma e kamatës për këto plasmane deri në tremujorin e tretë 2019 mesatarisht është rreth 0.366% ( minimum: 0% dhe maksimum: 5.37%), ndërsa në vitin 2018: në mesatare prej 0.659% (minimum: 0% dhe maksimum: 3.040%). Këto plasmane kryesisht kanë maturitet të kontraktuar deri në një vit. Analitika sipas bankave është e shpalosur në tabelën si më poshtë:

| Plasmanët në tregun e parasë sipas bankave: | 30 shtator 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| Deutsche Bank | 240,000,000.00 | 175,000,000.00 |
| FED New York | 9,367,251.34 | 8,734,361.96 |
| **Gjithsej** | **249,367,251.34** | **183,734,361.96** |

Ashtu sikurse edhe vërehet lehtë nëse i krahasojmë ka një rritje krahasuar në mes 31 dhjetorit 2018 dhe 30 shtatorit 2019 kryesisht e rrjedh nga një afatizim shtese në Deutsche Bank. Plasmanët aktive në euro në datën e raportimit janë 240 milion nga të cilave 220 milion janë plasman në formë të depozitës me mundësi thirrje/tërheqje me aftat të paracaktuar (Call Deposits) me maturitet të pacaktuar. Ndërsa, kemi një plasmanë prej 10.2 milionë në USD të

afatizuar në datën e raportimit (në tabelën e plasmanëve) është e shprehur kundërvlera në euro).

## 9. Mjetet e ndërlidhura me FMN

| | 30 shtator 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| Kuota me FMN | 103,415,464.74 | 100,296,274.71 |
| Depozitat në DST (SDR) | 64,579,156.65 | 64,890,248.43 |
| Kamata akruale | 597,213.04 | 721,461.70 |
| Përdorimi i fondeve të FMN-së (SBA) | 143,135,266.43 | 160,143,158.97 |
| **Gjithsej** | **311,727,100.86** | **326,051,143.81** |

Zërat më lartë rrjedhin nga anëtarësimi i Kosovës në FMN. Kuota në FMN paraqet vlerën e kuotës së obligueshme (82,600,000 SDR nga muaji shkurt 2016; ndërsa fillimisht ka qenë 59,000,000 SDR) që i është përcaktuar Kosovës nga FMN-ja e shprehur në euro.

Depozitat ne DST (SDR) paraqet fillimisht vlerën e depozituar në DST në emër të Republikës së Kosovës sipas vendimeve të Bordit të Guvernatorëve të FMN-së më 28 gusht 2009 (43,737,278 SDR) dhe 9 shtator 2009 (11,631,135 SDR) e ndryshuar për transaksionet – të hyrat dhe shpenzimet e interesit dhe pagesat në emër të rritjes së kuotës po ashtu të shprehura në euro në tabelën më lartë.
Depozitat në DST – Të Drejtat Speciale të Tërheqjes (Special Drawing Rights – SDR) janë depozita që sjellin interes mesatarisht prej 1.063% për periudhën raportuese janar - shtator 2019 (ndërsa për janar – shtator 2018, 0.892%).

Zëri *përdorimi i fondeve të FMN-së* paraqet mjetet e marra nga FMN-ja sipas marrëveshjeve aktive për shfrytëzim të linjës kreditore (SBA) nga Qeveria e Kosovës. Ndryshimi është rrjedhë e pagesave të kësteve dhe pjesërisht nga lëvizja e kursit të këmbimit EUR/SDR (vlerësimi i SDR-ve kundrejt EURO-s).

## 10, 11 Mjetet e prekshme dhe të paprekshme

| Kategoria e Mjeteve Themelore | Kosto Historike | Zhvlerësimi/ Amortizimi i Akumuluar deri më 31 dhjetor 2018 | Zhvlerësimi/ Amortizimi i akumuluar i vitit deri me 30 shtator 2019 | Gjithsej Zhvlerësimi/ Amortizimi i akumuluar 30 shtator 2019 | Vlera Neto më 30 shtator 2019 |
|---|---|---|---|---|---|
| ***Prona, ndërtesat dhe pajisjet*** | **10,431,257.61** | **5,101,935.38** | **475,982.37** | **5,577,917.75** | **4,853,339.86** |
| Pajisje, zyra dhe tjera | 2,465,287.14 | 1,907,382.85 | 122,258.58 | 2,029,641.43 | 435,645.71 |
| Automjetet | 389,349.16 | 290,593.50 | 22,873.12 | 313,466.62 | 75,882.54 |
| Ndërtesa | 5,306,554.44 | 1,153,434.48 | 196,890.48 | 1,350,324.96 | 3,956,229.48 |
| Pajisjet kompjuterike | 2,201,511.57 | 1,750,524.55 | 133,960.19 | 1,884,484.74 | 317,026.83 |
| Investime në proces | 68,555.30 | - | - | - | |
| ***Mjetet e Paprekshme*** | **4,246,837.87** | **2,180,954.60** | **295,516.21** | **2,476,470.81** | **1,770,367.06** |
| Aplikacionet kompjuterike | 4,013,794.87 | 2,180,954.60 | 295,516.21 | 2,476,470.81 | 1,537,324.06 |
| Aplikacione në proces | 233,043.00 | - | - | - | 233,043.00 |
| ***Gjithsej*** | **14,678,095.48** | **7,282,889.98** | **771,498.58** | **8,054,388.56** | **6,623,706.92** |

## 12. Mjetet tjera

Mjetet tjera përbëhen si më poshtë:

| | 30 shtator 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| Të hyra akruale | 1,136,150.76 | 1,278,473.28 |
| Parapagime | 348,095.43 | 131,966.6 |
| Pagesa/Kërkesa në proces (SNP/DepoX) | - | - |
| **Gjithsej** | **1,484,246.19** | **1,410,439.92** |

Kërkesat ne proces do të shlyhen pasi sistemi DepoX te ekzekuton pagesat ne ditën e parë te punës, nëse data e shlyerës se tyre është jo ditë pune p.sh fundjavë siç ka qene rasti.

## 13. Detyrimet ndaj bankave në vend

| | 30 shtator 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| ProCredit Bank - Kosovë | 56,793,218.82 | 40,597,389.47 |
| Raiffeisen Bank - Kosovë | 70,558,616.15 | 45,299,798.01 |
| NLB Prishtina | 70,928,402.33 | 69,917,264.03 |
| Komercijalna Banka - Dega Mitrovicë | 7,505,597.91 | 6,358,190.34 |
| Banka Ekonomike e Prishtinës | 37,776,198.20 | 55,869,253.21 |
| Banka për Biznes | 54,592,542.78 | 39,220,850.40 |
| Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë | 34,818,530.09 | 32,538,906.01 |
| Turk Ekonomi Bankasi Sh.A | 68,753,509.06 | 37,462,030.03 |
| Turkiye Is Bankasi A.S. | 18,903,693.62 | 14,421,855.38 |
| T.C. Zirat Bankasi A.S.Dega Kosovë | 5,289,094.06 | 1,678,865.90 |
| Banka Kreditore e Prishtinës | 15,859.72 | 29,310.15 |
| **Gjithsej** | **425,935,262.74** | **343,393,712.93** |

Të shpalosura në këtë grup janë saldot e bankave komerciale që operojnë në vend (Kosovë). Ato në BQK mbajnë mjetet sipas rregullativës ligjore për rezervën e likuiditetit. Në total shuma e shpalosur më lartë për periudhën raportuese 30 shtator 2019 është rreth 2.66 herë më e lartë se sa shuma e rezervës së obliguar që duhet mbajtur në BQK.

## 14. Detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN

| | 30 shtator 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| Llogaria rrjedhëse FMN Nr. 1 | 258,538.66 | 250,740.69 |
| Llogaria shpenzimeve FMN Nr. 2 | 6,260.02 | 6,071.20 |
| Llogaria e FMN-së, në përkujdesje | 221,170,748.20 | 235,824,955.07 |
| Pjesa e paguar e Kuotës te FMN-ja | 18,553,104.96 | 17,816,089.91 |
| Alokime nga FMN-ja në formë të DST | 69,321,430.54 | 67,230,575.79 |
| Kamata akruale | 604,577.32 | 725,659.33 |
| **Gjithsej** | **309,914,659.70** | **321,854,091.99** |

Zërat më lartë paraqesin pozicionet e llogarive të ndërlidhura me FMN-në që kanë rrjedhur pas anëtarësimit të Kosovës në FMN.

Të tre zërat e parë (tabela nën shënim 14) paraqesin llogari të hapura sipas rregullativës së FMN-së, dy janë llogari operative dhe një është llogari në përkujdesje për letrat me vlerë që Qeveria e Kosovës i ka lëshuar si nota të pagueshme ndaj FMN-së.

Pjesa e paguar e kuotës, ka të përfshirë edhe interesin e paguar nga IMF për këtë zë, sipas rregullativës së FMN-së, e cila në tabelë nën shënim 14 është e shprehur në euro.

Alokimet në formë të Drejtave Speciale të Tërheqjes (DST/SDR) në FMN, përbëhen nga alokimet e përmendura në ***shënimin 9*** më 28 gusht dhe 9 shtator 2009, të cilat së bashku gjithsej arrijnë vlerën prej 55,368,413 DST (SDR) po ashtu të shprehura në euro në tabelën e shënimit 14. Norma e interesit për zërin e alokimeve për periudhën raportuese është e njëjtë sikurse te depozitat DST (SDR).

## 15. Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare

Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare kanë këtë përbërje:

**Llogarit rrjedhëse**

| | **30 shtator 2019** | **31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| Thesari – Ministria e Financave | 647,817,903.86 | 374,662,826.78 |
| Agjencia Kosovare për Privatizim | 264,880,446.21 | 388,115,936.82 |
| Institucionet e përkohshme administrative | 396,138.52 | 122,123.61 |
| **Gjithsej (llogari rrjedhëse)** | **913,094,488.59** | **762,900,887.21** |

Depozitat në llogari rrjedhëse përfitojnë kamatë prej 0.00% (si për periudhën raportuese, ashtu edhe për periudhën krahasuese). Afatizime aktive në periudhën raportuese nuk ka, po ashtu edhe për vitin 2018, përkatësisht më 31 dhjetor 2018 nuk ka pasur afatizime aktive. Ndryshimi është rrjedhë e aktivitetit operativë të institucioneve që përbëjnë grupin.

## 16. Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale

Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale të paraqitura në vijim të gjitha janë mjete në llogari rrjedhëse:

| | **30 shtator 2019** | **31 dhjetor 2018** |
|---|---|---|
| Kompanitë e sigurimeve | 4,737,244.28 | 4,536,787.25 |
| Institucione dhe kompani publike | 44,828,326.99 | 106,324,447.65 |
| Fondet e pensioneve dhe tjera | 1,731.83 | 1,749.83 |
| **Gjithsej** | **49,567,303.10** | **110,862,984.73** |

Ka një zvogëlim krahasuar me 2018, që i atribuohet tërësisht grupit të institucioneve dhe kompanive publike respektivisht tërheqjes se mjeteve në vlerë rreth 63 milion nga llogaria në mirëbesim nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).

## 17. Detyrimet nga Huamarrja/et

| | 30 shtator 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| Huamarrje nga Banka Botërore | 2,266,259.07 | 2,266,259.07 |
| **Gjithsej** | **2,266,259.07** | **2,266,259.07** |

Kemi dy projekte që janë financuar nga Banka Botërore përmes kredisë: projekti për *Planin e vazhdimësisë së punës* dhe projekti për *Sistemin e pagesave në kohë reale* (RTGS). Projekte këto të implementuara në vitin 2016. Kthimi i mjeteve është me afat mbi 10 vjet.

## 18. Detyrime tjera

| | 30 shtator 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| Llogari në përkujdesje | 756,036.51 | 756,036.51 |
| Të hyrat e shtyra | 423,885.92 | 497,810.68 |
| Llogari të pagueshme dhe shpenzime akruale | 256,212.17 | 543,675.39 |
| **Gjithsej** | **1,436,134.60** | **1,797,522.58** |

Në kuadër të grupit vërehet zvogëlim i lehtë në gjithsej saldon e grupit krahasuar më 31 dhjetor 2018. Kryesisht i ndikuar nga zvogëlimi i saldos së *llogarive të pagueshme* dhe *të hyrave të shtyra* më 30 shtator 2019, krahas asaj më 31 dhjetor 2018.

## 19, 20 Kapitali i autorizuar dhe Rezervat

### Kapitali dhe Rezervat e Përgjithshme

| | 30 shtator 2019 | 30 dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| Kapitali i autorizuar | 30,000,000.00 | 30,000,000.00 |
| Fondet Rezervë | 23,989,459.17 | 21,801,120.78 |
| Rezultati neto i periudhës | 2,168,293.50 | 2,188,338.39 |
| **Gjithsej** | **56,157,752.67** | **53,989,459.17** |

Rezultati financiar i periudhës është pozitiv për rreth 2.168 milion euro, i ndikuar kryesisht nga realizimi i kënaqshëm për të hyrat dhe mbajtja e shpenzimeve sipas planifikimit buxhetor për periudhën raportuese. Zëri i rivlerësimit valutor në datën e raportimit është në vlerë prej rreth 563 mijë euro (si fitim i parealizuar), dhe nëse e përjashtojmë këtë rezultati financiar mbetet pozitiv prej rreth 1.605 milion euro.

## 21. Neto të hyrat nga kamatat

| | 30 shtator 2019 | 30 shtator 2018 |
|---|---|---|
| **Të hyrat nga kamata** | | |
| Prej afatizimeve në plasmane | 159,312.83 | 105,836.50 |
| Prej letrave me vlerë | 1,398,483.53 | 1,119,693.43 |
| Prej depozitave me llogaritë me FMN (DST/SDR ne posedim) | 516,721.91 | 436,696.38 |
| Prej normave negative në depozita[3] | 464,918.16 | 334,341.93 |
| | **2,539,436.43** | **1,996,568.24** |
| **Shpenzimet e kamatave** | | |
| Ndaj llogarive me FMN (DST/SDR të alokuar) | 547,476.67 | 441,864.49 |
| Ndaj bankave korrespondente | 516,644.42 | 268,101.95 |
| Nga huazimi/et | 11,678.44 | 1,270.48 |
| | **1,075,799.53** | **711,236.92** |
| **Neto të hyrat nga interesi** | **1,463,636.90** | **1,285,331.32** |

Siç mund të vërehet nga tabela nën shënimin 21, të hyrat nga kamatat janë realizuar më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Shpenzimet nga kamata po ashtu janë më të larta se periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Ndërsa, realizimi me i lartë i të hyrave nga kamata ka ndikuar që neto të hyrat nga kamata janë më të larta se periudha e njëjtë e vitit të kaluar.

Norma mesatare e kamatës për neto të hyrat nga kamatat (duke marrë në konsiderate vetëm portfolion e angazhuar) për periudhën raportuese është rreth 0.23% (në periudhën e njëjtë të vitit 2018 ka qenë rreth 0.17%).

## 22. Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat në shërbime

| | 30 shtator 2019 | 30 shtator 2018 |
|---|---|---|
| **Të hyrat nga tarifat dhe ndalesat** | | |
| Nga depozitat/tërheqjet në para të gatshme | 659,844.44 | 486,681.31 |
| Nga transferet hyrëse | 58,115.32 | 57,772.99 |
| Nga transferet dalëse | 248,235.14 | 213,451.54 |
| Nga transferet vendore (*Sistemi i pagesave vendore*) | 894,029.15 | 724,374.30 |
| Nga sistemi i regjistrit të kreditëve | 150,877.30 | 116,116.70 |
| Të hyra nga tarifa tjera | 20,955.00 | 28,107.00 |
| | **2,032,056.35** | **1,626,503.84** |
| **Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat** | | |
| Prej transportit të parasë së gatshme | 357,443.59 | 191,378.47 |
| Nga transaksionet me banka korrespondente | 10,280.80 | 35,307.58 |
| Prej shërbimeve të pagesave përmes SNP | - | - |
| | **367,724.39** | **226,686.05** |
| **Neto pozicioni nga tarifat dhe ndalesat** | **1,664,331.96** | **1,399,817.79** |

[3] Duke ju referuar normave negative që po përcjellin tregjet financiare të valutës euro, bazuar edhe në normat referente të BQE (ECB), BQK ka vendosur norma negative në disa nga depozituesit e saj që nga shtatori 2016.

Vërehet një rritje krahasuar me 30 shtator 2018, kjo është kombinim nga rrjedha normale (ndryshim në volum) e aktivitetit për zërat e shpalosur në kuadër të grupit si dhe nga rregullimet ne listën e tarifave për llojin e shërbimeve të shpalosura më lartë.

## 23. Të hyrat nga aktiviteti rregullator

| | 30 shtator 2019 | 30 shtator 2018 |
|---|---|---|
| Nga mirëmbajtja e licencave të bankave | 2,120,307.55 | 2,003,468.73 |
| Nga licencat prej institucioneve bankare | 31,700.00 | 22,500.00 |
| Nga mirëmbajtja e licencave të kompanive të sigurimeve | 918,744.87 | 867,284.64 |
| Nga licencat prej kompanive të sigurimeve | 69,200.00 | 64,700.00 |
| Të hyrat nga aktiviteti rregullator i fondeve pensionale | 19,442.25 | 18,972.58 |
| Nga aktiviteti rregullator i institucioneve tjera financiare (jobankare) | 197,789.49 | 185,633.11 |
| **Gjithsej** | **3,357,184.16** | **3,162,559.06** |

Ndryshimi si rritje kryesisht është e mbështetur në rritjen e bazës (volumit të aktivitetit) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018 (si rrjedhë e trendit historik që ka ky grup i zërave) dhe pjesërisht nga rregullimet ne listën e tarifave.

## 24. Të hyrat nga grantet

| | 30 shtator 2019 | 30 shtator 2018 |
|---|---|---|
| **Të hyrat nga grantet** | **86,356.87** | **73,587.11** |

Dy janë grantet që për nga pesha e dominojnë zërin nën shënimin numër 24. Ato janë: granti për sistemin e menaxhimit të gjithë procesit të *emetimeve të letrave me vlerë të Qeverisë* (ku i gjithë sistemi është dhënë si grant BQK-së nga Thesari - Ministria e Financave dhe granti për *sistemin e mbikëqyrjes financiare.*

*Ndërsa grantet për financim të trajnimeve dhe zhvillim te personelit (financuar nga ECB-Bundesbank) dhe ai i studimit të fizibilitetit për qendër të trajnimeve ka peshë shumë më të vogël.*

## 25. Të hyrat tjera operative

| | 30 shtator 2019 | 30 shtator 2018 |
|---|---|---|
| **Të hyra tjera** | **2,927.55** | **7,473.66** |

Ky grup përbehet nga të hyra prej aktiviteteve jo të zakonshme të BQK-së dhe të cilat nuk kanë mundur të klasifikohen në zërat specifikë të të hyrave. P.sh. shitja e tokenëve që

përmbajnë certifikata për qasje ne sistem Depo-x, për klientët shfrytëzues të sistemit në fjalë, kryesisht ndaj bankave komerciale dhe të ngjashme.

## 26. Shpenzimet e personelit

| | 30 shtator 2019 | 30 shtator 2018 |
|---|---|---|
| Shpenzimet e pagave dhe kompensimeve | 2,459,657.97 | 2,280,239.28 |
| Shpenzimet e kontributeve dhe sigurimi shëndetësor | 541,825.95 | 494,066.25 |
| Shpenzimet e trajnimeve | 80,775.35 | 53,171.27 |
| Shpenzimet për Bordin e BQK-së | 85,047.96 | 80,603.15 |
| Shujta ditore | 101,059.50 | 93,414.00 |
| Shpenzime tjera | 18,454.18 | 19,036.59 |
| **Gjithsej** | **3,286,820.91** | **3,020,530.54** |

Gjithsej numri i punëtoreve që kanë qenë aktivë në listën e pagave gjatë periudhës janar-shtator 2019 është: 232 (në periudhën janar - shtator 2018, 216).
Në kategorinë ***tjera të shpenzimet e personelit*** përfshihet *kompensimi shtesë pensional (2019, 8,100.39euro; 2018, 8,840.29euro)* dhe *mbështetja financiare për strehim (2019, 5,782.29euro; 2018, 5,878.80euro) si dhe pagesat për programin e praktikes për student (2019, 4,571.50euro, 2018, 4,317.50euro)*. Kompensimi shtesë pensional është rrjedhojë e vendimeve të mëhershme, nga ku disa ish punëtorë kompensohen drejtpërdrejt nga BQK-ja, në pamundësi për bartjen e këtij detyrimit ndaj tyre të fondet pensionale në momentin kur BQK-ja ka bartur menaxhimin e fondit shtesë pensional.

## 27. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

| | 30 shtator 2019 | 30 shtator 2018 |
|---|---|---|
| Shpenzimet e sigurimit | 234,361.49 | 212,149.37 |
| Riparime dhe mirëmbajte | 49,198.70 | 39,481.78 |
| Mirëmbajtje të aplikacioneve | 241,865.67 | 220,594.81 |
| Shpenzime komunikimi (telefoni, fax-i dhe interneti) | 18,036.97 | 11,849.20 |
| Shpenzimet e shërbimeve publike/komunale | 54,086.06 | 54,946.55 |
| Shpenzimet e konsultimeve dhe të auditimit | 9,379.80 | 6,151.93 |
| Shpenzime të sigurimit fizik (të objektit) | 55,310.40 | 47,736.00 |
| Udhëtimet dhe transporti | 108,359.82 | 76,838.51 |
| Shpenzimet operative të automjeteve | 11,865.20 | 10,510.39 |
| Material shpenzues administrativ | 15,762.85 | 5,314.54 |
| Shpenzimet e bufesë (për kafe ndaj personelit dhe takime të ndryshme) | 27,812.31 | 25,092.11 |
| Shpenzime për furnizime (për pajisje të TI dhe jo TI ) | 14,789.97 | 14,887.56 |
| Publikimet dhe literatura | 8,483.06 | 7,005.65 |
| Shpenzimet e përfaqësimit | 23,124.91 | 15,353.04 |
| Tarifa anëtarësimi në institucione profesionale[4] | 20,811.88 | 21,475.95 |
| Tjera[5] | 17,988.11 | 16,171.69 |
| **Gjithsej** | **911,237.20** | **785,559.08** |

[4] Në kuadër të kategorisë "Tarifa anëtarësimi në institucione profesionale" kryesisht janë këto: *Anëtarësimi në Shoqatën ndërkombëtare të sigurimeve (IAIS), Shoqatën ndërkombëtarë të pensioneve (IOPS), Shoqatën ndërkombëtare të regjistrit të kreditëve* (ACCIS), *Institutin për auditim të brendshëm* (IIA) dhe *Bordin për standarde të raportimeve financiare* (IASB-IFRS).
[5] Në kuadër të kategorisë "Tjera te shpenzimet e përgjithshme dhe administrative" për periudhat raportuese janë të përfshira: *gardërobë pune* rreth 7,203.79 euro (2019) dhe 7,656.41 euro (2018); shtypi ditor 596.30 euro (2019) dhe 334.8 euro (2018); *shpenzime operative për kartelat bankare dhe vlerat e shlyera* 3.74 euro (2019) dhe 30.30 euro (2018); *shpenzime të jashtëzakonshme* 4,864.19 euro (2019) dhe 4,473.38 euro (2018); dhe *shpenzimet për parking dhe për aktivitete sportive* (kryesisht terminët për shfrytëzimin e fushave për futboll dhe volejboll) 5,320.12 euro (2019) dhe 3,676.80 euro (2018).

Ndryshimet të shpenzimet e përgjithshme administrative janë rrjedhë e aktiviteteve dhe vendimeve operative si dhe pjesërisht nga ndonjë aktivitet që nuk ka pasur periodicitet të njëjtë në periudhat krahasuese. Por që shikuar si tërësi janë brenda trendit të tyre të zakonshëm/planifikuar.

## 28. Neto rezultati nga ndryshimet e kursit të këmbimit

| | 30 shtator 2019 | 30 shtator 2018 |
|---|---|---|
| **Rivlerësimi valutor** | | |
| nga zëri/at ne USD | 467,224.71 | 306,031.86 |
| nga zërat ne SDR | 96,188.04 | 86,681.93 |
| **Neto fitimi/(humbja) e parealizuar (nga ndryshimi i kursit të këmbimit)** | **563,412.75** | **392,713.79** |

Rezultati i paraqitur më lartë është i përkohshëm (specifikisht vetëm për datën e raportimit) dhe mund të lëvizë varësisht nga lëvizja e kursit të këmbimit EUR/SDR dhe EUR/USD.

## 29. Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj

| | Shënim | 30 shtator 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|
| Paraja e gatshme | 5 | 332,029,782.03 | 285,376,364.49 |
| Llogaritë rrjedhëse me bankat jorezidente | 6 | 263,230,505.31 | 34,797,033.53 |
| Letra më vlerë me maturitet deri në tre muaj | | - | - |
| Llogaritë depozituese me bankat jorezidente dhe me maturitet deri në tre muaj | | 9,367,251.34 | 8,734,619.64 |
| **Gjithsej** | | **604,627,538.68** | **328,908,017.66** |

## 30. Detyrimet e pritura dhe kontingjente

### Anëtarësimi në Bankën Botërore

Pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bankën Botërore dhe nënagjecionet e saj Qeveria e Kosovës ka lëshuar nota të pagueshme (sipas kërkesës) duke u zotuar se do të paguajë sipas kërkesës së Bankës Botërore (nënagjencioneve të saj) për pjesën e tarifës së anëtarësisë. Vlera e tyre më 30 shtator 2019 është rreth 645,152 euro (më 31 dhjetor 2018 ky detyrim i pritshëm ka qenë 645,152 euro), BQK luan rolin e ndërmjetësit financiar (bankës garantuese) dhe mjetet mbahen në llogari nën përkujdesje (garantuese).